

VENDIM
Nr. 406, datë 5.7.2023

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2023, NDËRMJET MINISTRISË SË KULTURËS DHE SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023 bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:
 - a) Ministrisë së Kulturës, në programin “Arti dhe kultura”, në shpenzime korrente, i shtohet fondi prej 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekësh, për promovimin e trashëgimisë kulturore nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve artistiko-kulturore përgjatë sezonit turistik veror 2023.
 - b) Shërbimit Informativ të Shtetit, në programin “Veprimtaria informative shtetërore”, në shpenzime korrente, i pakësohet fondi prej 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekësh.
 2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku